

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-41/13

Prishtinë,
25 qershor 2013

Në çështjen juridike të:

V. M.

Serbi

Pala përgjegjëse/Pala ankuese

kundër

B. M.

Prizren

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/153/2012 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA28536) të datës 19 prill, 2012, pas vendimmarrjes të mbajtur më 19 shkurt 2013, e shpallë këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e V. M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/153/2012 të datës 19 prill, 2012 sa i përket ankesës ë regjistruar në KPA me numrin KPA28536. Hedhet si e palejueshme pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me kompensimin e dëmit.
- 2- Ndryshohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/153/2012 i datës 19 prill, 2012 sa i përket rastit të regjistruar në KPA me numrin KPA28536, dhe kërkesa refuzohet si e pabazë.
- 3- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 45 (dyzet e pesë) euro, në afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së aktgjykimit ose nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 5 mars 2007, B. M. e parashtrori kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar kthimin e pronës. Ajo pretendon që biri i saj V.M. ka qenë pronar i një shitoreje me sipërfaqe 6m2 që ndodhet në Prizren në parcelën nr. 1075. Për ta mbështetur kërkesën e saj, ajo e parashtrori një vendim të Departamentit për Urbanizëm, Shërbime Komunale, Banimi dhe Ndërtim në Prizren – Nr. 04/4-351-33 të datës 4 prill 1996 – me të cilën V. M. është lejuar që përkohësisht ta vendosë një kioskë *“deri në ndarjen e parcelës së lartpërmendur për ndonjë qëllim tjetër”* Kërkesa është regjistruar me numër KPA28536.

Më 21 qershor 2007, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej kioska. Ata e gjetën kioskën duke u përdorur nga B.M. e cila deklaroi që parcela në të cilën ndodhej i përkiste familjes së saj dhe ishte marrë nga shteti. Andaj ajo ishte e interesuar për shfrytëzimin e pronës dhe e ka nënshkruar një njoftim pjesëmarrjeje.

Më 14 qershor 2010, njoftimi ishte përsëritur. Këtë herë zyrtarët e AKP-së e zbuluan që kioska nuk ekzistonte më dhe që vendi ishte shndërruar në parking.

Më 19 prill 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC) me vendimin e tij KPCC/D/C/153/2012 e hodhi poshtë kërkesën shkaku i mungesës së juridiksionit. KPCC deklaroi që në pah të Nenit 9 të ligjit mbi pronën dhe te drejtat tjera sendore (Ligji nr. 03/L-154) kioska duhej të konsiderohej si një objekt i luajtshme. Sipas paragrafit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KPCC, megjithatë, kishte kompetenca për të vendosur vetëm për pronat e paluajtshme.

Më 23 nëntor 2012, vendimi iu dorëzua B. M.. Më 21 dhjetor 2012, V. M. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) e parashtrroi ankesën në Gjykatën Supreme. Ai shpjegoi që kioska ishte një objekt i palëvizshëm, meqë ishte lidhur me tokën në mënyrë permanent përmes bazës së betonit me lidhje në kanalizimin e qytetit dhe lidhjen në ujësjellës, ishte ndërtuar nga trarë të trashë druri dhe kulmin e kishte të mbuluar me tjegulla. Pala ankuese deklaroi se pasi që kioska ishte një kapital në të cilin familja Mladenović kishin investuar, prona duhet të dëmshpërblehet.

Pala ankuese kërkon nga Gjykata që ta anulojë vendimin e KPCC-së sa i përket rastit në fjalë dhe ta kthejë rastin në KPCC, ose ta rishikojë vendimin dhe t'i pranoj të drejtat e palës ankuese për kthim të pronës ose të kompensimit të dëmit.

Ankesa i është dorëzuar B. M. më 28 mars 2013. Ajo nuk është përgjigjur fare.

Arsyetimi ligjor:

Gjykata dëshiron të theksojë që V. M. nuk është vetëm palë ankuese por edhe paraqitës i kërkesës. Kërkesa është parashtruar nga nëna e tij në emër të tij, me ankesa ai padyshim i ka aprovuar të gjitha veprimet e saj ligjore para KPCC-së.

Ankesa është pranueshme, por e pabazuar.

1. Gjykata megjithatë pajtohet me palën ankuese që rast i është nën juridiksion të KPCC-së dhe Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme. Kioska e në fjalë nuk mund të konsiderohet si pronë e luajtshme. Prona e paluajtshme përfshinë “ndërtesat e vendosura në tokë” (Neni 10.1 i ligjit mbi pronën dhe te drejtat tjera sendore). Meqë kioska nuk ishte ndërtuar në mënyrë solide por edhe sipas palës ankuese gjithashtu ka pasur themele betoni dhe ka qenë e lidhur në kanalizimin e qytetit, Gjykata e vërtetën që kioska ishte e vendosur në tokë dhe prandaj do të konsiderohet si e paluajtshme. Që pala ankuese e kishte lejen për

shfrytëzim të përkohshëm nuk e ndryshon këtë konstatim. Kur e ka ngritur kioskën pala ankuese ka planifikuar ta shfrytëzojë sa më gjatë që ishte e mundur dhe të zgjedh një strukturë të qëndrueshme.

2. Megjithatë ankesa mbetet e pasuksesshme.

- a. Sa i përket kërkesës të palës ankuese për ta shfrytëzuar përkohësisht një pjesë të parcelës ku ishte vendosur kioska, ky shfrytëzim i përkohshëm kishte përfunduar kur kioska ishte shkatërruar dhe se parcela ishte transferua në parking. Me këto veprime – ose me lejimin e këtyre veprimeve – Komuna padyshim e ka tërhequr lejen e shfrytëzimit të përkohshëm. Meqë kontrata e parasheh tërheqjen, Gjykata nuk e konsideron të gabueshme. Prandaj e drejta e palës ankuese që ta shfrytëzojë parcelën nuk ekziston më.
- b. Sa i përket kërkesës së palës ankuese për pronësi të kioskës, kjo do të thotë të vet ndërtesës, dhe kërkon kthimin e pronës ose dëmshpërblim, Gjykata vendosë si në vijim:
 - i. Kthimi i pronës është faktikisht i pamundur meqë kioska nuk ekziston më. Prandaj Gjykata nuk mund të vendosë për kthimin e pronës.
 - ii. Derisa pala ankuese me këtë ankesë për herë të parë kërkon dëmshpërblim, ankesa është a e palejueshme meqë KPCC dhe Kolegji i apelit i KPA-së nuk kanë juridiksion për të vendosur për kërkesat e dëmshpërblimit (Paragrafi 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Kërkesa për dëmshpërblim duhet të bëhet në gjykatën e rregullt civile.

Ky vendim nuk paragjykon të drejtën e paraqitësi të kërkesës për t'i kërkuar të drejtat e tij nga gjykatat kompetente.

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2) duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të përlogaritet të jetë 500€:15€.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë dhe jo më gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjyqi e cakton afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Neni 47 paragrafi 3 parashikon që në rast të mospagesës së tarifës brenda afatit, pala duhet të paguaj gjobën prej 50% të shumës së tarifës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it